



---

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË  
SENATI AKADEMIK**

**RREGULLORE E STUDIMEVE TË SPECIALIZIMEVE AFATGJATA,  
TË CIKLIT TË TRETË, NË FUSHËN E MJEKËSISË, NË  
UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË**

**Miratuar me Vendimin nr. 88, datë 16.11.2016,  
të Senatit Akademik të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, ndryshuar me Vendimin nr. 67,  
datë 21.12.2017, ndryshuar me Vendimin nr. 26, datë 03.04.2018, ndryshuar me Vendimin  
nr.4, datë 28.01.2019, të Senatit Akademik**

**TIRANË, 2019**

Kjo rregullore hartohet bazuar në: Ligjin Nr. 80/2015, datë 22. 07. 2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"; neni 69, pika 3; neni 70, pika 4; neni 77, pika 1 dhe 3; neni 78, pika 1 dhe 3; neni 132; Kodin e Procedurave Administrative; Ligjin Nr. 7961, datë 12.7.1995 "Kodi i Punës të Republikës së Shqipërisë"; Aktet nënligjore të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, në fuqi.

## **I. Dispozita të Përgjithshme**

### **Neni 1**

Programi i specializimit afatgjatë, përfshin formim të karakterit teorik dhe praktik në fushën e specialitetit përkatës, i cili realizohet në strukturat universitare të Universitetit Mjekësisë, Tiranë (UMT), në strukturat spitalore të Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza" (QSUT) dhe qendra të tjera spitalore universitare, si dhe në struktura të tjera të akredituara dhe aprovuara për këtë qëllim nga ministria përgjegjëse për shëndetësinë dhe ministria përgjegjëse për arsimin, konform standardeve shtetërore të cilësisë për specializimet afatgjata në Mjekësi, që do të bëhen pjesë e rrjetit formues, me të cilat UMT do të lidhë marrëveshjet përkatëse paraprakisht në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

### **Neni 2**

Programet specializuese afatgjata, synojnë të edukojnë dhe të specializojnë studentë, të cilët në përfundim të këtyre programeve specializuese, të ofrojnë një shërbim cilësor shëndetësor të specializuar dhe bashkëkohor për pacientin, për trajtimin dhe parandalimin e patologjive të ndryshme, duke ndjekur rregullat e etikës dhe deontologjisë në fushën përkatëse, si edhe përmes kërkimit shkencor, për të mundësuar ngritjen e një sistemi shëndetësor konform standardeve më të mira evropiane.

### **Neni 3**

Programi i studimeve të specializimit afatgjatë, kryhet me kohë të plotë pranë strukturave të rrjetit formues ku është përcaktuar të kryhet specializimi, në përputhje me programin përkatës të specializimit, procedurat e përcaktuara, si dhe nën mbikëqyrjen e personave dhe autoritetit apo entit përgjegjës. Mjeku specializant vepron konform kësaj rregullore dhe programit përkatës specializues, si dhe rregullave të strukturës në të cilën ndjek programin përkatës. Specializanti angazhohet me kohë të plotë për 40 orë në javë, pranë strukturave ku është përcaktuar të ndjekë programin specializues dhe ka detyrimin e kryerjes e të paktën 24 rojeve klinike në vit, nën mbikëqyrje për ato programe specializuese që parashikojnë roje duke filluar që nga viti i parë. Përfshirja në aktivitetin kliniko-profesional fillon që me fillimin e programit të studimit të specializimeve afatgjata.

#### **Neni 4**

Specializanti duhet të marrë gjatë periudhës së specializimit njohuri teorike dhe praktike, të mjaftueshme për ushtrimin e funksioneve të tij si mjek i specializuar, në mënyrë të pavarur në përfundim të specializimit afatgjatë, në fushën e trajtimit, diagnostikimit dhe parandalimit të patologjive. Për realizimin e sa më sipër ai ushtrohet gjatë periudhës së specializimit në mënyrë të pavarur por nën mbikëqyrjen e pedagogëve, mjekëve specialistë, udhëheqësve klinikë dhe tutorëve, të cilët e ndjekin specializantin gjatë punës së tij.

#### **Neni 5**

Kuotat e pranimeve të reja në programet specializuese afatgjata në mjekësi dhe tarifatat përkatëse të shkollimit, si dhe kriteret dhe procedurat specifike të aplikimit, konkurrimit dhe regjistrimit, përcaktohen çdo vit akademik me propozim të Rektoratit, miratuara në Senatin Akademik, dhe shpallur nga Rektori i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, në përputhje me politikat shtetërore të zhvillimit të fushës së shëndetësisë dhe kapacitetet pritëse të UMT dhe të strukturave pjesë e rrjetit formues përkatës.

#### **Neni 6**

Për specializantët që kanë përfituar nga kuotat e mbuluara nga ministria përgjegjëse për shëndetësinë apo nga Ministri të tjera, marrëdhëniet kontraktuale financiare lidhen mes specializantit dhe Ministrisë përkatëse. Për shërbimin e rojeve 24-orëshe, mjeku specializant do të përfitojë shpërblimin financiar sipas akteve nënligjore të strukturave pjesë e rrjetit formues përkatës.

#### **Neni 7**

Programet e studimeve të specializimeve afatgjata ofrohen konform standardeve Shtetërore të Cilësisë për Specializimet Afatgjata në Fushën e Mjekësisë dhe përshtaten në strukturë me programet homologe të zhvilluara në vendet e BE, direktivat e BE për profesionet e rregulluara, si dhe me standardet e cilësisë të përcaktuara sipas akteve nënligjore në fuqi.

#### **Neni 8**

Në përfundim të specializimit afatgjatë, mjeku i specializuar që ka përfituar nga kuotat e mbuluara nga Ministrinë përkatëse, ka detyrimin të zbatojë të gjitha kushtet e parashikuara në kontratat e lidhura paraprakisht me palët në momentin e regjistrimit në programin specializues. Kontrata miratohet me urdhër/udhëzim të Ministrisë të Ministrisë përkatëse. Në rast

mosrespektimi të kontratës, mjeku i specializuar paguan penalitetet përkatëse, si dhe shlyen detyrime të tjera, sipas përcaktimeve të bëra në kontratë.

## **II. Struktura e programeve të studimeve të specializimeve afatgjata në fushën e mjekësisë**

### **Neni 9**

Programet e studimeve specializuese afatgjata përfshijnë të paktën 80% të ECTS-ve totale për aktivitete klinike profesionalizuese, sipas specializimit përkatës, dhe 20% për studime të organizuara teorike të shpërndara në vite sipas një programi të paracaktuar në fillim të programit të studimit. Raporti i lëndëve të përcaktuara në programin e specializimit afatgjatë përbehet nga 60% lëndë specifike të programit të specializimit dhe 30% lëndë karakterizuese të fushës ku bën pjesë programi specializues, si dhe 10% lëndë që përfshijnë formimin bazë, lëndë ndërdisiplinore, deontologjinë dhe kodin e etikës, provimin përfundimtar etj. 15% e totalit të lëndëve specifike dhe 15% e totalit të lëndëve karakterizuese duhet të jenë lëndë me zgjedhje.

### **Neni 10**

Programet e studimeve të specializimeve afatgjata në fushën e mjekësisë realizohen nëpërmjet një strukture organizative të përshtatshme, me kapacitetet e nevojshme profesionale dhe pedagogjike ku përfshihen pedagogë, tutorë (udhëheqës klinikë) dhe ekspertë të fushës së specializimit.

### **Neni 11**

Çdo program specializues përcakton:

- a) Një figurë drejtuese, Drejtuesin e programit të specializimit. Përgjegjësi i programit të specializimit duhet të jetë personel akademik me kohë të plotë i kategorisë “Profesor” dhe me të paktën 10 vjet përvojë në ushtrimin e profesionit.
- b) Një këshill drejtues të programit të studimit të specializimeve afatgjata, i cili në bashkëpunim me përgjegjësin e programit të specializimit, punon për përgatitjen, organizimin dhe kontrollin e programit të specializimit në fjalë.
- c) Një përgjegjës për menaxhimin ekonomik – financiar dhe përmbushjen e kërkesave administrative në nivel fakulteti (Administratori dhe Zyra e Financës).
- d) Për monitorimin dhe vlerësimin e brendshëm është përgjegjëse Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.

### **Neni 12**

Këshilli Drejtues i programit përkatës të studimeve specializuese afatgjata ngrihet në nivel Departamenti dhe përbëhet nga të paktën 5 (pesë) pedagogë të UMT, të cilët duhet të jenë figura

të spikatura në fushën e specialitetit përkatës, me përvojë klinike dhe akademike të paktën 10 – vjeçare, të kategorisë “Profesor” ose me gradë shkencore Doktor/PhD të fituar në universitete të njohura jashtë vendit, sipas Shtojcës nr. 1 bashkëlidhur kësaj rregulloreje, si dhe të kenë kryer kërkime dhe botime shkencore brenda dhe jashtë vendit. Në rastet kur numri i mësipërm i anëtarëve të Këshillit Drejtues nuk plotësohet brenda Departamentit, Dekani fton të bëhen pjesë përbërëse e tij autoritete akademike të fushave të përafërta brenda UMT. Përgjegjësi i Programit të Specializimit, i cili është njëkohësisht edhe kryetari i Këshillit Drejtues, zgjidhet nga anëtarët e këtij këshilli me shumicë të thjeshtë votash (50% + 1).

### **Neni 13<sup>1</sup>**

Programi i studimeve të specializimeve afatgjata duhet të disponojë në nivel departamenti

- a) Personel Akademik me kohë të plotë me tituj dhe grada shkencore: profesorë, profesorë të asociuar dhe lektorë, për jo më pak se 50% të pedagogëve të përfshirë në programin specializues. Të paktën një profesor i brendshëm duhet t’i përkasë disiplinës/fushës së programit të specializimit përkatës.
- b) Personel Akademik me kohë të pjeshme dhe mbikëqyrësi klinik, të cilët ushtrojnë profesionin në strukturat e rrjetit formues, sipas Nenit 1 të kësaj rregulloreje: personel me eksperiencë didaktike – formuese të dokumentuar dhe me eksperiencë profesionale pranë strukturave të përfshira në rrjetin formues, për një maksimum prej 50% të pedagogëve, me të cilët lidhet një kontratë sipas nevojës së strukturës të programit specializues.
- c) Personel Akademik të jashtëm me kontratë: ekspertë të sektorëve të ndryshëm disiplinorë, për një numër maksimal prej 10% të numrit total të pedagogëve, të cilët mund të angazhohen vetëm në mungesë të profesorëve universitarë.

### **Neni 14**

Të paktën 50% e numrit të kërkuesve të angazhuar në programet e studimeve të specializimeve afatgjata duhet të jenë personel akademik me kohë të plotë të kategorisë “Profesor”, të angazhuar aktivisht në punën klinike ose me gradë shkencore “Doktor” apo “PhD”, të fituara në universitete të mirënjohura në botë dhe të shquar për cilësi dhe veprimtari të pasur klinike/kërkimore dhe botuese në fushën përkatëse.

### **Neni 15**

Studenti ka një tutor (udhëheqës klinik) që e ndjek atë gjatë gjithë periudhës së specializimit dhe është përgjegjës për drejtimin, këshillimin, vlerësimin e nevojave të studentit si edhe për zhvillimin dhe monitorimin e punës së studentit. Fusha e specializimit të udhëheqësit përputhet me atë të programit specializues që ndjek specializanti. Tutori ka një eksperiencë

---

<sup>1</sup> Ndryshuar me Vendimin nr.4, datë 28.01.2019 të Senatit Akademik

profesionale të paktën 10 (dhjetë) vjeçare me përvojë klinike në fushën klinike përkatëse dhe ka të paktën gradën shkencore “Doktor”. Numri maksimal i studentëve specializantë që mund të ndiqet nga një tutor është 3 (tre). Tutori është personel i punësuar me kohë të plotë pranë njërës nga strukturat e rrjetit formues dhe ka një kontratë bashkëpunimi me strukturën që ofron programin specializues, të paktën sa kohëzgjatja e programit specializues.

Kur tutori nuk është pjesë e personelit akademik të institucionit që ofron programin e specializimit, i caktohet edhe një udhëheqës akademik, anëtar i personelit akademik me kohë të plotë të institucionit, me së paku gradën shkencore “Doktor” apo “PhD” (të fituar në universitete, të mirënjohura në botë – Shtojca 1) në fushën në të cilën vazhdon studimet specializanti.

Nëse udhëheqësi kryesor nuk është në dispozicion, studentit i bëhet e ditur se cili do të jetë personi që do ta zëvendësojë atë.

## **Neni 16**

Tutorët (udhëheqësit klinikë) të aftë për të drejtuar punën klinike e kërkimore të specializantëve, propozohen nga Këshilli Drejtues i programit, përzgjidhen nga departamenti dhe miratohen nga Dekanati përkatës dhe shpallen nga Rektori i UMT. Fusha e specializimit të tutorit duhet të përputhet me atë të programit specializues që ndjek specializanti.

Për çdo specializant në momentin e regjistrimit, ose brenda 7 ditëve nga regjistrimi i tij në programin specializues, i përcaktohet nga departamenti që mbulon specializimin përkatës një tutor nga lista e tutorëve të aprovuar. Emri i tutorit i komunikohet menjëherë Dekanatit dhe sekretarisë përkatëse për ta mbajtur dhe evidentuar në regjistrat përkatës dhe dosjen e studentit. Tutori është përgjegjës për zbatimin e programit të studimit të specializimit që ndjek në strukturat e rrjetit formues; njëkohësisht merret me organizimin dhe ndjekjen nga afër të praktikave klinike në përputhje me programin mësimor. Tutori në rolin e udhëheqësit klinik i mëson procedurat teknike dhe praktike specializantit, nëpërmjet përfshirjes së drejtpërdrejtë të tij në të gjitha etapat e diagnozës dhe trajtimit të pacientëve. Tutori përcjell nëpërmjet shembullit personal tek specializantët parime të shëndosha etike të komunikimit me pacientët, të afërmit e tyre dhe ndërmjet kolegëve, bazuar në principet e deontologjisë moderne mjekësore. Tutori jep Përgjegjësit të programit të specializimit, miratimin që studenti specializant është i aftë të kryejë me sukses procedura teknike, praktikë mjekësore (ekzaminime, procedura terapeutike dhe kirurgjike etj.) nën mbikëqyrje të drejtpërdrejtë dhe si i pavarur.

## Neni 17

Në përfundim të çdo viti akademik studimesh, organizohet provimi vlerësues teorik dhe praktik, i cili vlerësohet me kalues se jo. Vlerësimi vjetor kryhet nga një komision i përbërë nga të paktën 5 (pesë) specialistë me përvojë të fushës përkatëse, ose të afërt me të sipas moduleve të zhvilluara. Specializantët që vlerësohen jo kalues 2 (dy) herë, marrin një dëshmi për modulet e zhvilluara, së bashku me kreditet e grumbulluara dhe i ndërpresin studimet e specializimeve afatgjata. Studenti mund të aplikojë për të transferuar në një program tjetër specializues jo më shumë se 1 herë. Studentit mund t'i njihen ECTS-të e grumbulluara për studimet e organizuara teorike nga ana e Dekanatit sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, nëse gjykohet se përputhen me fushën e programit të ri ku ai ka aplikuar.

## Neni 18<sup>2 3</sup>

Specializanti i nënshtrohet provimit përfundimtar në fund të programit specializues, pasi të ketë të botuar ose të pranuar të paktën një artikull shkencorë në revistën shkencore të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë (AJMHS) ose në revistën shkencore të fakultetit përkatës. Provimi përfundimtar konsiston në një testim praktik, një testim teorik, prej të paktën 30 minutash, si edhe paraqitjen e temës eksperimentale – studimore të diplomës. Për këtë qëllim ngrihet një komision në nivel departamenti, prej të paktën 5 (pesë) specialistë të fushës, ose të një fushe të përafërt, me eksperiencë të paktën 10 (dhjetë) vjeçare profesionale dhe akademike në fushën në fjalë. Kryetar i komisionit është i kategorisë “Profesor”.

Pjesë e testimit përfundimtar janë disa nga njohuritë bazë si:

- a. Zhvillimi i sensit kritik lidhur me situatat e ndryshme klinike;
- b. Lidhjet mes fushave të ndryshme të mjekësisë;
- c. Aftësi të zhvilluara për zgjidhjen e problemeve që dalin gjatë punës në klinikë;
- d. Kompetencë për të menaxhuar kompleksitetin e situatave klinike dhe për të dhënë zgjidhje në raste emergjente.

### **III. Pranimi i studentëve në një program studimi specializues afatgjatë në fushën e mjekësisë**

## Neni 19

Aplikojnë për një specializim afatgjatë në fushën e mjekësisë kandidatët që kanë përfunduar programin e studimeve universitare të integruar të ciklit të dytë me kohëzgjatje të paktën 5 vjeçare (300 ECTS) për degët Farmaci dhe Stomatologji dhe të paktën 6 vjeçare (360 ECTS) për

<sup>2</sup> Ndryshuar me Vendimin nr.67, datë 21.12.2017 të Senatit Akademik

<sup>3</sup> Ndryshuar me Vendimin nr.4, datë 28.01.2019 të Senatit Akademik

degën Mjekësi e përgjithshme, si dhe programin e studimit Master i Shkencave me kohëzgjatje 2 vjeçare (120ECTS) në Shëndet publik, pranë një universiteti tjetër të akredituar për programin në fjalë, si dhe ata që kanë fituar diplomën universitare jashtë Republikës së Shqipërisë “Master i Shkencave” në një nga programet e mësipërme të studimit të njohur nga ministria përgjegjëse për arsimin.

#### **Neni 20<sup>4</sup> 5**

Kandidatët që aplikojnë për specializim afatgjatë duhet:

1. Të kenë përfunduar studimet në programet e ciklit të dytë, të përcaktuara në nenin 19 të kësaj rregulloreje, dhe janë pajisur me diplomën përkatëse.
2. Të kenë kryer me sukses provimin përkatës të shtetit, konform ligjit nr. 10171, datë 22.10.2009 “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe të kenë fituar të drejtën e ushtrimit të profesionit përkatës në Republikën e Shqipërisë ose jashtë saj (të njohur në Republikën e Shqipërisë).
3. Të zotërojnë të paktën një nga gjuhët e huaja: anglisht, italisht, frëngjisht, gjermanisht, spanjisht, sipas akteve nënligjore në fuqi.
4. Nuk mund të konkurrojnë kandidatët që janë duke kryer ose që kanë kryer një program specializimi afatgjatë ose që kanë jo më pak se 2 (dy) muaj të çregjistruar nga një program specializimi afatgjatë nga data e parë e aplikimit të programit aktual.
5. Llogaritja e notës mesatare të notave të ponderuara me kreditet e të gjitha viteve të programit të studimit universitar të çdo kandidati bëhet nga sekretaria mësimore e fakultetit përkatës dhe konfirmohet nga një komision i veçante ad-hoc i ngritur me vendim të Rektorit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.
6. Për studentët e diplomuar në të njëjtat programe studimi jashtë shtetit në vendet perëndimore, të përcaktuara në Shtojcën nr. 1, të cilëve u njihet diploma për ushtrimin e profesionit përkatës në këto vende, llogaritja e notës mesatare të ponderuar behët nga sekretaria mësimore sipas përcaktimeve të pikës 5.

#### **Neni 21**

Kandidati aplikon sipas formularit të aplikimit bashkëlidhur kësaj rregulloreje (Shtojca nr. 2) dhe i nënshtrohet konkursit të pranimit për të testuar njohuritë në fushën përkatëse të studimit. Kriteret specifike shtesë për t'u pranuar në programin e specializimeve afatgjata janë kompetencë e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë. Zgjedhja e programit specializues bëhet në bazë të renditjes së kandidatit sipas pikëve të përfituara (listës së meritës).

---

<sup>4</sup> Ndryshuar me Vendimin nr.67, datë 21.12.2017 të Senatit Akademik

<sup>5</sup> Ndryshuar me Vendimin nr.4, datë 28.01.2019 të Senatit Akademik



## Neni 22

Procesi i aplikimeve fillon jo më vonë se 3 (tre) javë kalendarike përpara datës së konkurrimit dhe mbyllet jo më vonë se 7 (shtatë) ditë kalendarike përpara datës së konkurrimit. Lista emërore e kandidatëve të regjistruar për konkurrim shpallet në faqen ueb të fakultetit përkatës dhe të UMT-së, jo më vonë se 2 (dy) ditë pune përpara datës së konkurrimit dhe i dërgohen ministrisë përgjegjëse për arsimin dhe QSHA-së jo më vonë se 4 (katër) ditë nga data e konkurrimit. Ora dhe vendi i konkurrimit shpallen dhe afishohen pranë fakultetit dhe departamenteve përkatëse, UMT-së, në faqet ueb përkatëse të paktën 4 (katër) ditë para konkurrimit.

## Neni 23

Aplikimi bëhet pranë strukturës së përcaktuar për pritjen e aplikimeve nga fakulteti që ofron programin përkatës specializues. Kandidati paraqet dokumentacionin e mëposhtëm në momentin e aplikimit:

1. Formular aplikimi, sipas modelit të përcaktuar në Shtojcën 2 (për rastet e transferimeve, sipas modelit të përcaktuar në Shtojcën 2a).
2. Një letër motivimi e aplikantit.
3. Fotokopje e dokumentit të identifikimit të vlefshëm, kartë identiteti ose pasaportë.
4. Kopje e njësuar me origjinalin në Republikën e Shqipërisë e diplomës universitare dhe listës së notave. Për rastet e diplomave të huaja paraqitet kopje e njësuar me origjinalin e vërtetimit të njohjes në Republikën e Shqipërisë, e shoqëruar me diplomën dhe listën përkatëse të notave ose të një dokumenti tjetër të vlefshëm për regjistrimin në Universitet në vendin ku janë kryer studimet të lëshuar nga institucioni i arsimit të lartë përkatës. Në rast se njohja e diplomës nuk ka përfunduar ende, kandidati paraqet vërtetim që ka dorëzuar dokumentacionin për njohje në ministrinë përgjegjëse për arsimin, dhe duhet të dorëzojë dokumentin e njohjes jo më vonë se data e parashikuar për testimin e informatizuar, si dhe përpara shpalljes së rezultatit përfundimtar nga Komisioni i Vlerësimit.
5. Kopje e njësuar me origjinalin në Republikën e Shqipërisë e dokumentit që vërteton njohjen e gjuhës së huaj, sipas parashikimeve në nenin 20.
6. Fotokopje e licencës për ushtrimin e profesionit në Republikën e Shqipërisë dhe e dëshmisë së regjistrimit në Urdhrin profesional përkatës, të njësuar me origjinalin në Republikën e Shqipërisë.
7. Dëshmi penaliteti e vlefshme.
8. Mandat pagesa për tarifën e aplikimit dhe konkurrimit.

Kandidatët që aplikojnë për transferim studimesh, përveç dokumentacionit të sipërcituar, duhet të dorëzojnë edhe dokumentacionin si më poshtë vijon:

9. Planin e plotë të programit të studimit specializues të ndjekur;

10. Vërtetim të listës së notave dhe krediteve të fituara për çdo lëndë dhe detyrim të shlyer, si edhe syllabuset përkatëse për lëndët e shlyera, i cili do të shërbejë për ekuivalentimin e notave të lëndëve të programit të studimit të ndjekur;
11. Vërtetim për periudhat e praktikave dhe frekuentimin e aktiviteteve të parashikuara në programin specializues të ndjekur.

#### **Neni 24**

Në momentin e aplikimit kandidatit i dorëzohet:

1. Kopje e formularit të aplikimit e firmosur nga palët dhe me vulë të fakultetit përkatës.
2. Programi orientues i testit të konkurrimit, ose adresa ueb përkatëse ku mund ta konsultojë atë.
3. Rregullorja e konkurrimit, ose adresa ueb përkatëse ku mund ta konsultojë atë.
4. Të dhënat për datën e konkurrimit dhe dokumentet eventuale që duhet të paraqesë ditën e konkurrimit, si dhe ku mund të informohet lidhur me vendin dhe orën e testeve.

#### **Neni 25**

Konkurrimi për programet specializuese afatgjata në fushën e mjekësisë parashikon zhvillimin e 3 fazave, në renditje kronologjike, si më poshtë:

1. Intervistën me gojë;
2. Testimin e informatizuar;
3. Vlerësimin e notës mesatare të studimeve universitare.

Për kryerjen e intervistës me gojë, kandidatët ndahen në grupe në bazë shorti. Për kryerjen e testimit, kandidatët që aplikojnë në programet specializuese i nënshtrohen testimit të informatizuar.

#### **Neni 26**

Lista e kandidatëve, që kanë aplikuar pranë fakulteteve, të cilët plotësojnë kriteret për të marrë pjesë në procesin e konkurrimit për programet specializuese afatgjata për të cilat kanë aplikuar, dërgohet nga Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, në ministrinë përgjegjëse për arsimin dhe QSHA, brenda 4 (katër) ditëve nga përfundimi i aplikimeve, sipas formatit të përcaktuar paraprakisht nga QSHA-ja. Ajo i shpërndahet nga Dekanati edhe komisioneve përkatëse të intervistës dhe vlerësimit.

Fakulteti përkatës është përgjegjës për saktësinë dhe verifikimin e hartimit të listave të kandidatëve.

## Neni 27<sup>6</sup>

Rektori i UMT, sipas propozimeve të dekanëve përkatës, shpall komisionet e vlerësimit, si dhe datat përkatëse të zhvillimit të intervistës me gojë dhe të testimit të informatizuar. Testimi i informatizuar zhvillohet pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore (QSHA).

Komisionet e intervistës krijohen në bazë shorti ditën e parashikuar për zhvillimin e intervistës, para zhvillimit të saj. Anëtarët e komisioneve të intervistës propozohen nga përgjegjësit e departamenteve dhe miratohen nga dekani. Për hedhjen e shortit, dekani i fakultetit përkatës ngrë Komisionin e Shortit, të përbërë prej 5 anëtarësh.

Ministria përgjegjëse për arsimin dhe ministria përgjegjëse për shëndetësinë kanë të drejtën e dërgimit të ekipeve për vëzhgimin për monitorimin e procesit.

Komisioni i Vlerësimit kryesohet institucionalisht nga dekani i fakultetit ose një përfaqësues i caktuar prej tij dhe plotësohet me 1 (një) përfaqësues të Rektoratit të UMT-së. Komisioni i Vlerësimit përbëhet prej të paktën 7 (shtatë) anëtarësh. Pjesa tjetër e anëtarëve përcaktohet nga dekani prej pedagogëve me eksperiencë në fushat e programeve të specializimeve për të cilat zhvillohet konkurrimi.

Ministria përgjegjëse për arsimin dhe ministria përgjegjëse për shëndetësinë kanë të drejtën e dërgimit të ekipeve për vëzhgimin për monitorimin e procesit.

## Neni 28

Komisionet e Intervistës kryejnë, administrojnë dhe përmbyllin në nivel Fakulteti procesin e intervistës me secilin nga kandidatët. Komisioni i Intervistës përbëhet prej 5 (pesë) anëtarësh, sipas procedurës së parashikuar në nenin 27, si edhe nga një sekretar (pa të drejtë vote). Rektorati i UMT mund të kenë vëzhguesit e vet në të gjitha procedurat e parashikuara për zhvillimin e intervistës. Kryetari i Komisionit të Intervistës zgjidhet nga anëtarët e komisionit me shumicë të thjeshtë votash (50% + 1).”

## Neni 29<sup>7</sup>

Zhvillimi i Intervistës:

- a) Në intervistë marrin pjesë të gjithë konkurruesit që kanë aplikuar në një nga specializimet që mbulon fakultetet e UMT-së.
- b) Komisioni i Intervistës ka të drejtë të pyesë gjatë intervistës kandidatin për ta kuptuar më mirë dhe vlerësuar në lidhje me edukimin e profesionalizmin e tij, duke evituar gjykimet personale dhe çdo lloj diskriminimi të mundshëm.

<sup>6</sup> Ndryshuar me Vendimin nr.67, datë 21.12.2017 të Senatit Akademik

<sup>7</sup> Ndryshuar me Vendimin nr.4, datë 28.01.2019 të Senatit Akademik

- c) Anëtarët e komisionit japin vlerësimin e aplikantëve individualisht nga 0 (zero) deri në 10 (dhjetë) pikë me votim të fshehtë. Rezultatet mblidhen dhe i përcillen brenda ditës dekanit të fakultetit përkatës.
- d) Mbas përfundimit të intervistës, Komisioni i Vlerësimit, pas aprovimit nga Dekani, shpall rezultatet përfundimtare të intervistës me gojë në faqen ueb të fakultetit përkatës dhe UMT-së, si edhe në ambientet e fakultetit dhe rektoratit.

### **Neni 30**

Komisioni i Intervistës vlerëson kandidatin për aspektet e mëposhtme: aftësitë e gjyqimit të kandidatit; motivimi për të vazhduar specializimin për të cilin ka aplikuar; profilin e përgjithshëm psikologjik; predispozicionin për të punuar në grup; aftësitë dhe nivelin e komunikimit; nivelin e kulturës së përgjithshme; nivelin e shprehjes dhe kulturës mjekësore, aftësinë për të punuar në kushtet e stresit të zgjatur; tiparet e përgjithshme të metodicitetit në punë dhe aftësinë për të lexuar dhe analizuar një material të mirëfilltë shkencor mjekësor.

### **Neni 31<sup>8</sup>**

#### **Mënyra e zhvillimit dhe administrimit të testimit të informatizuar**

1. Provimet e specializimit zhvillohen në QSHA në datat e përcaktuara nga Rektori i UMT-së, bazuar në disponeshmërinë e ambienteve të testimit të përcaktuara nga QSHA-ja.
2. Ditën e zhvillimit të provimit, kandidatët duhet të kenë parasysh rregullat e mëposhtme:
  - a) të jenë të pajisur me dokument identiteti (kartë identiteti ose pasaportë) dhe me një fotokopje të saj, si dhe të jenë të pajisur me mandat-pagesë për tarifën e testit të informatizuar për llogari të QSHA-së;
  - b) të paraqiten së paku 30 minuta përpara fillimit të provimit/testimit;
  - c) ndalohet mbajtja dhe përdorimi i celularëve dhe mjeteve të tjera të komunikimit gjatë zhvillimit të provimit, pasi kjo vlerësohet si kriter skualifikimi;
  - d) ndalohet duhani dhe konsumimi i ushqimit në mjediset e provimit;
  - e) ndalohet komunikimi gjatë zhvillimit të provimit.
3. Sallat e provimit mbikëqyren nga një ose më shumë administratorë, të cilët janë përgjegjës për mbarëvajtjen e provimit/testimit sipas rregullave të përcaktuara në këtë rregullore.

### **Neni 32**

Pyetjet për testin e informatizuar të konkurrimit dhe programi orientues eventual, përgatiten nga fakulteti që ofron programin e specializimeve përkatëse mbi bazën e kurrikulës së studimeve universitare dhe shpallen nga Dekani. Programi duhet të sigurojë testimin e njohurive,

<sup>8</sup> Ndryshuar me Vendimin nr.4, datë 28.01.2019 të Senatit Akademik

kapacitetit, aftësive të aplikantëve në këndvështrime të ndryshme (operativ, konjitiv dhe relacionues).

### **Neni 33**

Pyetjet e testimit, programi orientues eventual, mënyra e testimit dhe rregullorja e specializimeve dhe/ose ndryshimet eventuale të tyre, shpallen të paktën 4 (katër) javë para datës së testimit të informatizuar të paktën 1 (një) javë para datës së fillimit të aplikimeve. Mënyra e testimit dhe rregullorja e specializimeve dhe ose ndryshimet eventuale të tyre shpallen përpara fillimit të aplikimeve. Ato afishohen pranë Fakulteteve përkatëse, UMT-së, faqeve ueb zyrtare si dhe iu shpërndahen të gjithë kandidatëve në momentin e aplikimit.

### **Neni 34<sup>9</sup>**

Komisioni i Vlerësimit është sipas fushave kryesore të specializimit sipas fakulteteve të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.

Komisioni i Vlerësimit drejtohet nga kryetari, i cili mbledh komisionin, drejton diskutimet, koordinon punën dhe siguron zbatimin e ligjit. Komisioni i Vlerësimit shprehet nëpërmjet vendimeve që merren me shumicë të thjeshtë të anëtarëve të komisionit.

### **Neni 35**

Për hartimin e fondit të pyetjeve për zhvillimin e testimit të informatizuar pranë institucionit përgjegjës ngrihet nga Dekani një grup pune, me përfaqësues nga specialitetet kryesore dhe me pedagogë të fakultetit përkatës.

Hartuesit e fondit të pyetjeve ndërtojnë fondin e pyetjeve me përgjigjet përkatëse, për testimin e informatizuar, me të paktën 4 (katër) përgjigje, nga të cilat vetëm njëra është përgjigja e saktë, dhe eventualisht programin orientues për çdo specialitet.

Hartuesit e fondit të pyetjeve hartojnë fondin e pyetjeve edhe në bazë të standardeve të përcaktuara nga QSHA-ja, si dhe bëjnë grupimin e tyre në nivele vështirësie si më poshtë vijon: Niveli 1: i lehtë, Niveli 2: mesatar dhe Niveli 3: i vështirë, duke u konvertuar respektivisht në 1 pikë, 2 pikë dhe 3 pikë.

Gjatë hartimit të fondit të pyetjeve, hartuesit duhet të zbatojnë standardet për hartimin e pyetjeve me alternativa të miratuara nga Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA). Hartuesit kanë përgjegjësi për saktësinë e pyetjeve të hartuara nga ana e tyre dhe për zbatimin e Ligjit nr. 9380, datë 28.04.2005 “Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të”, i ndryshuar.

### **Neni 36**

Komisioni i Vlerësimit në funksionimin e tij, lidhur me zhvillimin e testimit të informatizuar, ndjek procedurat e mëposhtme:

<sup>9</sup> Ndryshuar me Vendimin nr.67, datë 21.12.2017 të Senatit Akademik

- a. Komisioni merr në dorëzim nga hartuesit fondin e pyetjeve të provimeve të specializimit;
- b. Komisioni shqyrton fondin e pyetjeve me synimin për përfaqësimin sa më të mirë të njohurive të programit, duke konsideruar:
  - i. peshën e secilës pjesë të programit që do të përfaqësohet në test dhe përputhshmërinë e pyetjeve me programin eventual orientues të shpallur, si dhe formulimin e saktë të tyre nga ana e përmbajtjes. Kur komisioni konstaton se nuk përmbushen këto kushte, atëherë ai ndryshon formulimin e pyetjes duke e bërë atë të vlefshme për fondin e pyetjeve, ose e heq atë.
  - ii. përcaktimin e vështirësisë së pyetjeve duke bërë ndryshime nëse e sheh të arsyeshme;
  - iii. përcaktimin e numrit të alternativave (nga katër deri në pesë alternativa).
- c. Komisioni miraton me shumicë të thjeshtë votash fondin e pyetjeve dhe ia dorëzon Dekanit fondin e miratuar të pyetjeve me alternativat përkatëse të përgjigjeve ku saktësohet përgjigja e saktë, dhe eventualisht programin orientues.
  - i. Komisioni i Vlerësimit konfirmon, para fillimit të procesit të aplikimeve, % e përfshirjes së pyetjeve sipas nivelit të vështirësisë duke marrë paraprakisht mendimin e QSHA-së lidhur me karakteristikat e programit të informatizuar që përdoret për zhvillimin e testimit;
- d. Komisioni i dorëzon Dekanit të fakultetit përkatës, të paktën brenda 7 (shtatë) ditëve kalendarike, fondin e miratuar të pyetjeve. Dekani shpall dhe përcjell fondin e pyetjeve brenda 2 (dy ditësh) kalendarike për në QSHA.
- e. Në ditën e zhvillimit të testimit të informatizuar duhet të jenë të pranishëm shumica e thjeshtë e anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit sipas një kalendarit të miratuar nga kryetari i komisionit të vlerësimit.
- f. Komisioni asiston në prodhimin elektronik të tezës së provimit të specializimit dhe kryen kontrollin e saj, para se ajo t'i shpërndahet kandidatëve. Nga komisioni mbahet procesverbali përkatës për saktësinë e pyetjeve të përzgjedhura nga sistemi për tezën përkatëse.
- g. Komisioni ndjek gjatë gjithë kohës procedurat dhe zhvillimin e testimit të informatizuar pranë QSHA-së deri në përfundimin e tij dhe firmosjen e procesverbalit me rezultatet e testimit;
- h. Komisioni dhe një përfaqësues i UMT-së, specialist IT bashkëpunon me përfaqësuesit e QSHA-së për mbarëvajtjen e provimit të informatizuar të specializimit.

### **Neni 37**

Komisioni i Vlerësimit ka dhe këto detyra/përgjegjësi të tjera:

- a) Shqyrton e miraton programin eventual orientues të testimit të informatizuar;
- b) Përgjigjet për saktësinë e fondit të pyetjeve dhe përgjigjeve respektive për çdo program specializimi afatgjatë;
- c) Ndjek dhe i përgjigjet ankimimeve të bëra nga kandidatët;

- d) Përgatit listën përmbledhëse të meritës me rezultatet kumulative të intervistës, testimin të informatizuar dhe notës mesatare në formë shkresore dhe të informatizuar.
- e) Asiston në procesin e zgjedhjes së specialitetit përkatës nga kandidatët sipas listës së meritës.

#### **Neni 38<sup>10 11</sup>**

Vlerësimi i kandidatit do të bëhet me sistem pikësh (maksimumi 1000 pikë të konvertuara), 30% e pikëve (300 pikë të konvertuara) do të vijnë nga nota mesatare (e rrumbullakosur me dy shifra pas presjes dhjetore), 65% e pikëve (650 pikë të konvertuara, të rrumbullakosura me dy shifra pas presjes dhjetore) do të vijnë nga testimi i informatizuar me pyetje me alternativa, i cili do të përmbajë 100 pyetje, si dhe 5% (50 pikë) nga intervista me gojë. Kandidatët që kanë grumbulluar jo më pak se 380 pikë nga numri i pikëve totale të konvertuara (maksimumi 1000 pikë), kualifikohen për procesin e përzgjedhjes së programit të specializimit sipas sistemit të meritës.

#### **Neni 39<sup>12 13</sup>**

Si notë mesatare do të konsiderohet nota mesatare e ponderuara, e të gjitha viteve të studimeve universitare të kryera, duke përfshirë dhe diplomimin.

Për kandidatët që kanë kryer studimet në IAL private brenda vendit, nota mesatare shumëzohet me një koeficient 0,8. Për kandidatët që kanë kryer studimet në IAL publike ose private brenda vendit, të cilat lëshojnë diploma të përbashkëta me universitete perëndimore, të përcaktuara në shtojcën nr. 1, nota mesatare shumëzohet me një koeficient 1. Për kandidatët që kanë kryer studimet në IAL publike brenda vendit nota mesatare shumëzohet me një koeficient 1, për kandidatët që kanë kryer studimet jashtë vendit në një nga vendet e parashikuara në shtojcën nr. 1, nota mesatare shumëzohet me 1,1.

Konvertimi i pikëve nga nota mesatare e përlllogaritur si më sipër duke e shumëzuar dhe me koeficientin përkatës, bëhet sipas modalitetit të përshkruar më poshtë: Nota mesatare e përlllogaritur 10 = 300 pikë të konvertuara, nota e përlllogaritur 9 = 240 pikë të konvertuara, nota e përlllogaritur 8 = 180 pikë të konvertuara, nota e përlllogaritur 7 = 120 pikë të konvertuara, nota e përlllogaritur 6 = 60 pikë të konvertuara, nota e përlllogaritur 5 = 0 pikë të konvertuara. Çdo 0.10 e notës mesatare të përlllogaritur është baras me 6 pikë të konvertuara (p.sh. nota mesatare 7,10 = 126 pikë të konvertuara, 8,20 = 192 pikë të konvertuara, 9,34 = 260.4 pikë të konvertuara, etj).

Formula e përlllogaritjes së pikëve të mesatares së ponderuar është:  $(Nmp-5)*60$ .

<sup>10</sup> Ndryshuar me Vendimin nr.67, datë 21.12.2017 të Senatit Akademik

<sup>11</sup> Ndryshuar me Vendimin nr.4, datë 28.01.2019 të Senatit Akademik

<sup>12</sup> Ndryshuar me Vendimin nr.26, datë 03.04.2018 të Senatit Akademik

<sup>13</sup> Ndryshuar me Vendimin nr.4, datë 28.01.2019 të Senatit Akademik

#### **Neni 40**

Konkursi për programin e studimeve të ciklit të tretë për specializim afatgjatë në fushën e mjekësisë, do të shpallë fitues konkurruesit me pikë më të larta sipas rendit zbritës (listë merite) brenda çdo tipologjie kuotash të shpallur me vendim të Rektorit Universitetit të Mjekësisë, Tiranë që akordon kuotat, sipas preferencës së kandidatit të shprehur në momentin e zgjedhjes, si dhe disponibilitetit të kuotave në programin përkatës të studimit.

#### **Neni 41**

Testi i konkurrimit hartohet me 100 pyetje me pyetje me alternativa (në një ose dy runde sipas mundësisë teknike për realizimin e testimit në QSHA), me përgjigje me jo më pak se 4 (katër) alternativa, nga të cilat vetëm njëra duhet të jetë e saktë. Testi i përbashkët i konkurrimit administrohet nga QSHA-ja, sipas modelit të testimit të provimit të shtetit.

#### **Neni 42**

Nëse një kandidat nuk paraqitet në provim ose tërhiqet përpara fillimit të tij, atëherë provimi nuk vlerësohet si i kryer.

Tërheqja nga testimi i informatizuar nuk mund të kryhet pas hyrjes në sallën e provimit.

Në rast se kandidati do të tërhiqet nga testimi i informatizuar pas fillimit të testimit, në përfundim të testimit duhet të firmosë deklaratën me rezultatin e marrë.

Kandidati që del nga salla e testimit nuk do të rihyjë në sallën e provimit.

#### **Neni 43**

##### **Modalitetet e zhvillimit të testimit të informatizuar**

1. Për çdo seancë provimi, pyetjet e përzgjedhura nga sistemi në mënyrë automatike janë të njëjta për të gjithë kandidatët pjesëmarrës në testimin e informatizuar. Në varësi të sistemit të testimit, nëse nuk është e mundur shpërndarja e të gjitha pyetjeve njëherësh, pyetjet i kalohen kandidatëve në dy runde me nga 50 pyetje me vështirësi dhe pikë totale të barabarta.
2. Testimi i informatizuar zgjat 120 minuta dhe zhvillohet në një raund të vetëm ose në dy runde prej 60 minutash secili sipas mundësisë teknike për realizimin e testimit në QSHA. Ai fillon dhe mbaron njëkohësisht për të gjithë kandidatët pjesëmarrës në testim, në ditën dhe orarin e caktuar.
3. Vlerësimi i kandidatëve kryhet në mënyrë automatike nga sistemi kompjuterik në momentin e përfundimit të testimit. Rezultati përfundimtar i shfaqet kandidatit në monitor dhe printohet në mënyrë automatike nga sistemi së bashku me përgjigjet e dhëna. Çdo kandidat firmos fletën me rezultatet e testimit të printuar në përfundim të testimit përkatës.



4. QSHA-ja dhe çdo përfaqësues i Komisionit të Vlerësimit kanë të drejtë që në rast se evidenton shkelje të rënda të rregullave të provimit, t'i propozojë Komisionit të Vlerësimit, skualifikimin e kandidatit që thyen rregullat. QSHA-ja dhe çdo përfaqësues i Komisionit të Vlerësimit mban procesverbal ku evidenton shkeljet e konstatuara.
5. Nëse konstatohet se provimi nuk është zhvilluar sipas rregullave, atëherë për kandidatët e kësaj salle, provimi do të vlerësohet si jo i kryer. Vendimi në këtë rast është në kompetencë të QSHA-së dhe Komisionit të Vlerësimit.
6. QSHA-ja i përcjell Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, listën e rezultateve të testimit të informatizuar në përfundim të çdo dite të zhvillimit të provimit.

#### **Neni 44**

Procedurat e konkurrimit dhe vlerësimit:

- a. Intervista me gojë kryhet nga të gjithë kandidatët dhe zhvillohet para testimit të informatizuar sipas kalendarit të shpallur. Rezultati i intervistës me gojë shpallet detyrimisht përpara kryerjes së testimit të informatizuar dhe daljes së rezultatit të këtij testimi.
- b. Testimi i informatizuar kryhet në QSHA. Komisioni i vlerësimit është i pranishëm në hedhjen e shortit për përzgjedhjen e pyetjeve të testimit dhe ndjek të gjitha procedurat e testimit përmes video monitorëve pa marrë pjesë fizikisht në sallat e testimit. Të gjitha ankimimet lidhur me procesin e konkurrimit i drejtohen Komisionit të Vlerësimit, i cili i merr ato në shqyrtim rast pas rasti dhe i kthen përgjigje ankimesve, sipas afateve të parashikuara në këtë rregullore.
- c. Nëse gjatë shqyrtimit të ankimimit nga ana e Komisionit të Vlerësimit, konstatohen gabime në pyetje, këto pyetje nuk merren parasysh. Në këtë rast ulet edhe numri maksimal i pikëve kundrejt të cilave përlogariten pikët e ponderuara të testimit të informatizuar. Vlerësimi për të gjithë kandidatët që kanë zhvilluar testin që përmban këtë pyetje/këto pyetje përlogaritet duke mos konsideruar pyetjen/pyetjet me gabime.
- d. Rezultatet e testimit të informatizuar iu bëhen të njohura kandidatëve menjëherë pas përfundimit të provimit përkatës. Rezultatet firmosen nga të gjithë anëtarët e Komisionit të Vlerësimit që janë të pranishëm në momentin e printimit të rezultateve nga sistemi i informatizuar, në 3 kopje, nga të cilat një kopje ruhet në QSHA, një i dërgohet UMT në formë shkresore, dhe një e mban Komisioni i Vlerësimit. Rezultatet shpallen në faqen ueb të fakultetit përkatës dhe UMT-së.
- e. Ndaj rezultateve të testimit të informatizuar, konkurruesit mund të paraqesin ankesa me shkrim brenda dy ditëve nga marrja e rezultatit. Në këto raste, Komisioni i Vlerësimit shqyrton ankesën dhe merr vendim përfundimtar lidhur me ankimimin e kësaj faze jo më vonë se 48 orë.
- f. Komisioni i Vlerësimit, në përfundim të intervistës me gojë dhe të testimit të informatizuar, konverton mesataren e ponderuar të studentit sipas dokumentacionit e certifikuar, pikët e marra në testimin e informatizuar ato të marra në intervistën me gojë dhe nxjerr totalin e

pikëve të kandidatit. Llogaritja e notës mesatare të notave të ponderuara me kreditet e të gjitha viteve të programit të studimit universitar të çdo kandidati bëhet sipas nenit 20, pika 1 të kësaj rregulloreje. Në përfundim të procesit, Komisioni i Vlerësimit përpilon listën përfundimtare me renditjen e kandidatëve sipas pikëve totale të fituara ku përcaktohen, gjithashtu, dhe pikët për vlerësimin e mesatares, testimin me gojë/intervistës dhe testimin të informatizuar. Kandidatët që rezultojnë me numër të njëjtë pikësh do të diferencohen, duke përfshirë edhe më shumë se dy shifra pas presjes dhjetore. Nëse edhe pas kësaj numri i pikëve rezulton i njëjtë, hidhet short mes kandidatëve. Listat përfundimtare shpallen në faqen ueb të fakultetit përkatës dhe UMT-së.

- g. Kandidatët mund të ankimojnë rezultatin përfundimtar brenda 2 ditësh nga shpallja e tij. Komisioni i Vlerësimit merr në shqyrtim ankimimet dhe prononcohet brenda 3 ditësh me vendimin përkatës.

#### **Neni 45<sup>14</sup>**

Zgjedhja e programit të specializimit afatgjatë bëhet brenda dy ditëve nga shpallja e rezultateve përfundimtare, përfshirë dhe procedurat e ankimimit sipas afateve të përcaktuara në këtë rregullore. Të drejtën e regjistrimit si fitues e kanë aq persona sa janë edhe kuotat e caktuara në programin e specializimit përkatës, sipas rendit zbritës të pikëve totale.

Zgjedhja e specializimit bëhet në mënyrë transparente, nga vetë kandidatët, sipas renditjes në listën përfundimtare, për secilën tipologji kuotash të miratuar në Vendimin e Rektorit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, sipas rendit zbritës të pikëve të fituara nga çdo kandidat, në prani të Komisionit të Vlerësimit, të drejtuar nga Dekani, ose përfaqësuesi i tij, me praninë e të interesuarve (në grupe me nga 5 konkurrues).

Kandidati përfitues i kuotave të mbuluara nga ministria përkatëse, duhet të paraqesë kontratën e nënshkruar me ministrinë përkatëse, jo më vonë se 2 (dy) javë nga data e regjistrimit.

#### **Neni 46<sup>15</sup>**

Procesverbali me rezultatin definitiv të fituesve sipas kuotave të programeve të studimit firmoset nga anëtarët e Komisionit të Vlerësimit dhe aplikanti dhe përcillet në Rektorat.

#### **Neni 47<sup>16</sup>**

Regjistrimi i kandidatëve fitues:

<sup>14</sup> Ndryshuar me Vendimin nr.4, datë 28.01.2019 të Senatit Akademik

<sup>15</sup> Ndryshuar me Vendimin nr.4, datë 28.01.2019 të Senatit Akademik

<sup>16</sup> Ndryshuar me Vendimin nr.4, datë 28.01.2019 të Senatit Akademik

- a. Kandidatët, që shpallen fitues, duhet të regjistrohen pranë fakultetit përkatës brenda 7 (shtatë) ditëve punëve nga data e përzgjedhjes së specializimit, për të fituar statusin e specializantit.
- b. Kandidatët që regjistrohen si specializantë duhet të paraqesin një dokument identifikimi (kartë identiteti ose pasaportë biometrike) dhe mandat pagesën për tarifën e regjistrimit sipas përcaktimeve në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.
- c. Kandidatët që do të regjistrohen në kuadër të kuotave të transferimit duhet të dorëzojnë dhe dokumentin e çregjistrimit nga programi i specializimit nga ku transferohen. Në rastet e transferimit nga programe specializuese jashtë vendit, në pamundësi të depozitimit të vërtetimit të çregjistrimit brenda afateve të parashikuara për regjistrim, kandidati regjistrohet me rezervë deri në depozitimin e vërtetimit përkatës. Nëse kandidati nuk e depoziton dokumentin e çregjistrimit brenda një muaji nga data e shpalljes së fituesve, Fakulteti çregjiston kandidatin dhe mund të vijojë me regjistrimin eventual të kandidatit konkurrues vijues në listën përkatëse.
- d. Në kryerjen e procedurës së regjistrimit, nga struktura e përcaktuar nga fakulteti përkatës për kryerjen e këtyre procedurave mbahet një regjistër i veçantë, ku kandidatët fitues nënshkruajnë në momentin e regjistrimit, duke shënuar datën dhe orën e regjistrimit. Në këtë regjistër, kandidati duhet të nënshkruajë edhe në rastin e çregjistrimit nga programi specializues ku është regjistruar, duke humbur të drejtën e vazhdimin të këtij specializimi në të ardhmen.
- e. Kandidati fitues që regjistrohet pajiset me një vërtetim regjistrimi të posaçëm, ku përveç emrit të kandidatit shënohet data dhe ora e regjistrimit. Vërtetimi i regjistrimit duhet të jetë i nënshkruar nga punonjësi i ngarkuar për këtë qëllim dhe Dekani dhe i vulosur me vulën e fakultetit përkatës.

#### **IV. Të drejtat dhe detyrimet e studentit të një programi studimi specializimi afatgjatë në fushën e mjekësisë**

##### **Neni 48**

Studenti kryen programin e specializimit afatgjatë me kohë të plotë në strukturat e rrjetit formues ku është përcaktuar të kryhet specializimi në përputhje me programin përkatës. Gjatë formimit të tij specializanti merr dijeni teorike, shprehi praktike si edhe elementët e nevojshëm etikë dhe profesionalë. Ai është i detyruar të marrë pjesë në realizimin e programit teorik dhe praktik të specialitetit përkatës me të cilin njihet që në fillim të specializimit. Objektivat kryesore të programit të studimit të specializimeve afatgjata në fushën e mjekësisë janë angazhimi i vazhdueshëm në punën klinike e kërkimore – shkencore dhe nxitja e punës në ekip e studentëve. Studenti duhet të marrë pjesë në aktivitete të ndryshme klinike të lidhura ngushtë me fushën specifike në të cilën ndjek studimet e specializimit, të cilat e ndihmojnë të aftësohet për:

- a) Përvetësimin e metodologjive dhe njohurive klinike e kërkimore për veprimtari krijuese të pavarura si: artikuj shkencorë, prezantime etj;
- b) Punën e pavarur në laborator/klinikë/sallë operatore;
- c) Përdorimin e burimeve bashkëkohore të informacionit (p.sh. bibliotekat dhe internetin, databazat me karakter shkencor/klinik) dhe administrimin e informacionit;
- d) Përdorimin e teknologjive bashkëkohore për prezantime shkencore;
- e) Përvetësimin e metodave të avancuara të analizës dhe përpunimit të të dhënave;
- f) Njohjen dhe përvetësimin e terminologjisë së specializuar lidhur me fushën klinike të specializimit.

#### **Neni 49**

Studenti i programit specializues merr pjesë në aktivitetet e parashikuara të programit të studimit, jashtë punës së tyre klinike. Specializanti është i lirë të marrë pjesë si dëgjues apo si referues në:

- a) Leksione;
- b) Seminare;
- c) Debate ndërdisiplinore të organizuara në kuadër të programit të specializimeve;
- d) Mundësi të tjera të të mësuarit si: ndjekja e prezantimeve të konferencave dhe seminareve të ndryshme me karakter klinik.

#### **Neni 50**

Studentit të pranuar në programin e studimeve specializuese afatgjata duhet t'i krijohen kushtet e nevojshme për të realizuar programin e studimit me karakter akademik e klinik. Programi i studimeve specializuese afatgjata duhet të sigurojë harmonizimin e synimeve të studentit në fushën klinike dhe kërkimore – shkencore dhe në përfundim të tij, edhe mundësinë për një karrierë profesionale dhe punësim. Studentit duhet t'i sigurohet vazhdimisht një mbështetje teknike e vazhdueshme për zhvillimin e aktivitetit klinik dhe kërkimor të lidhur me të.

#### **Neni 51**

Fakulteti përkatës ndjek procedura të qarta për vlerësimin në vazhdimësi të dijeve të studentit, të përcaktuara dhe të bëra të ditura që në fillim të programit të studimit. Konkluzionet e vlerësimit në vazhdimësi duhet të jenë të qarta dhe transparente, përfshirë edhe pezullimin, zgjatjen apo përjashtimin nga studimet specializuese.

Spektori i fakultetit përkatës mban, në formë të shkruar dhe të informatizuar, një pasqyrë të përvitshme për numrin e studentëve dhe të diplomuarve në programet specializuese afatgjata, tërheqjet nga programi i studimit, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik.

## Neni 52

Në vlerësimin përfundimtar studenti duhet të japë prova se ka fituar:

- a) Njohuri të thelluara në fushën përkatëse;
- b) Njohuri të thelluara në disa fusha të afërta me të;
- c) Aftësi profesionale dhe shkencore në përdorimin e teknologjisë bashkëkohore për zgjidhjen e problemeve klinike që lidhen me fushën e tij të specializimit dhe integrimin e njohurive të fituara për zgjidhjen e situatave komplekse klinike;
- d) Njohuri të përditësuara dhe risi, për të zgjeruar dhe rinfreskuar njohuritë ekzistuese;
- e) Autonomi, integritet shkencor, profesional dhe përkushtim për zhvillimin e ideve të reja;
- f) Aftësi bashkëpunimi në grup për zgjidhjen e situatave të ndryshme klinike;
- g) Nivel të lartë të sjelljes etike dhe profesionale.

Studenti jep prova që me anë të punës së tij klinike ka fituar aftësinë dhe kompetencat profesionale dhe shkencore të nevojshme për të ushtruar profesionin në mënyrë të pavarur.

## Neni 53

Specializanti vlerësohet për çdo lëndë me provim me notë, e cila depozitohet në sekretarinë e përcaktuar për këtë qëllim nga fakulteti përkatës. Studentit specializant i jepet e drejta për të hyrë në provimin përfundimtar pas shlyerjes së të gjitha detyrimeve vjetore, të parashikuara në planin mësimor dhe shqyrtimit të dosjes së tij nga këshilli i programit specializues, i cili e vlerëson atë pozitivisht apo negativisht. Dosja e kandidatit përmban vlerësimet mbi praktikat dhe modulet mësimore të kryera si edhe vlerësimet periodike nga ana e tutorit. Në rast vlerësimi negativ nga këshilli i programit specializues, studentit i komunikohet vendimi si edhe pjesët që duhet të përsërisë në mënyrë që të mund të hyjë në provimin përfundimtar. Vlerësimi përfundimtar vjetor i specializantëve bazohet në rezultatet e vlerësimeve periodike vjetore, në provimin përfundimtar dhe temën eksperimentale të diplomës si dhe gjykimin e pedagogëve dhe të udhëheqësit dhe bëhet me notë kaluese nga 5 (pesë) deri në 10 (dhjetë) ose jo kaluese, 4 (katër).

Specializanti që përfundon të gjitha detyrimet teorike dhe praktike, sipas planit mësimor dhe që ka marrë vlerësimin përfundimtar, merr Diplomë Specializimi në specialitetin përkatës duke fituar kështu të drejtën e ushtrimit të profesionit si specialist.

## Neni 54

Fakulteti, që ofron programin e studimit, vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit të specializimit afatgjatë bibliotekën e tij shkencore, të pasur me botime në letër dhe në formë elektronike me infrastrukturë të teknologjisë së informacionit (IT), që përfshin një listë të

botimeve periodike dhe programeve kompjuterike, si libraritë elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit.

#### **Neni 55**

Studenti specializant merr pjesë aktive në të gjithë aktivitetin e Departamentit dhe Shërbimit universitar në të cilin specializohet, gjithmonë nën përgjegjësinë e pedagogëve, tutorëve dhe mjekëve specialistë të rrjetit formues. Specializanti duhet të plotësojë të gjitha detyrat që i besohen, në mënyrë që të sigurohet vazhdimësia e funksionimit të mirë të Shërbimit duke respektuar Rregulloren e strukturave të rrjetit formues ku punon gjatë periudhës së specializimit.

#### **Neni 56**

Specializanti ka të drejtën e pushimit vjetor 4 javor në periudhën e parashikuar në strukturën mësimore të rrjetit formues. Koha e pushimit vjetor përcaktohet në marrëveshje me drejtuesit e programit të specializimit përkatës. Për mungesat për arsye shëndetësore, duhet të depozitohet raport mjekësor. Në rast se mungesat janë mbi 30% të ciklit apo modulit mësimor, ky i fundit duhet përsëritur. Në rast leje lindjeje, specializimi do të shtyhet për aq kohë sa është leja e lindjes, në mënyrë që të kryhet i plotë programi teorik e praktik. Në raste fatkeqësish familjare, specializanti mund të mungojë për një periudhë jo më shumë se 7 (shtatë) ditë kalendarike dhe të shlyejë detyrimet në një kohë të mëvonshme.

#### **Neni 57**

Specializanti duhet të regjistrohet çdo vit në sekretarinë përkatëse të Fakultetit. Regjistrimi do të bëhet vitin e parë pas bërjes së kontratës përkatëse duke paguar tarifën e shkollimit të përcaktuar sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi, dhe në vitet në vazhdim duke shlyer tarifën e shkollimit, si dhe vetëm në rast se janë shlyer detyrimet përkatëse të çdo viti sipas planit mësimor. Detyrime të mbartura lejohen vetëm për rastet parashikuara në nenin 56. Specializanti nuk lejohet të përsërisë vitin, përveç rasteve të parashikuara në nenin 56. Specializimi nuk mund të zgjasë më tepër se 1 vit nga kohëzgjatja zyrtare e tij.

#### **Neni 58**

Specializanti që nuk fiton vlerësimin përfundimtar, ka të drejtë t'i nënshtrohet edhe një herë tjetër këtij vlerësimi, por jo më vonë se 1 (një) vit pas përfundimit të specializimit. Studenti regjistrohet si student përsëritës dhe paguan tarifën e plotë të shkollimit për vitin që ndjek. Gjatë këtij viti studenti frekuenton aktivitetet përkatëse profesionale me kohë të plotë, pa përfutuar shpërblim/mbulim nga Ministria përkatëse nga të cilat ka përfutuar kuotë të mbuluar. Specializanti, i cili nuk i është nënshtruar vlerësimit përfundimtar brenda 1 (një) viti nga

përfundimi i specializimit, humbet të drejtën e marrjes së Diplomës së Specialitetit, por atij i jepet një certifikate që vërteton se ka kryer ciklin e plotë të studimeve të specialitetit, përveç diplomimit, dhe lista shoqëruese e notave të marra dhe aktiviteteve të kryera, bashkë me kreditet përkatëse.

#### **Neni 59<sup>17</sup>**

Specializanti ka të drejtë që një pjesë të periudhës së specializimit ta kryejë jashtë shtetit, duke transferuar dhe njohur kreditet e fituara atje, pas miratimit nga drejtuesi i programit të studimit specializues afatgjatë, drejtuesi i njësisë bazë (departamenti) dhe dekani i fakultetit, të kërkesës të specializantit, së cilës i bashkëlidhet dhe konfirmimi nga institucioni pritës për periudhën kohore të qëndrimit, si dhe programin e pjesshëm të specializimit që do të kryejë atje.

#### **Neni 60**

Studenti specializant gjatë gjithë procesit formues dhe kryerjes së detyrave të tij profesionale duhet të ndjekë rregullat e sjelljes etike dhe profesionale me pacientët, pedagogët dhe kolegët, gjithnjë brenda normave të deontologjisë mjekësore, duke fituar aftësi për komunikim korrekt me të tjerët. Në rast thyerjesh dhe shkeljesh disiplinore, ai i nënshtrohet, si të gjithë mjekët e tjerë, masave disiplinore të marra nga Urdhri i Mjekut dhe organet e tjera kompetente.

#### **Neni 61**

Studentët e programit të studimeve afatgjata të specializimit në fakultetet përbërës të UMT-së kanë të drejtë të zgjedhin dhe të zgjidhen, duke u përfaqësuar në organet kolegjiale sipas kuadrit ligjor në fuqi.

#### **Neni 62**

Studentët e programit të studimeve afatgjata të specializimit në Fakultetet e UMT-së kanë detyrim:

- a) Të zbatojnë statutet dhe rregulloret e të gjitha strukturave universitare dhe spitalore të rrjetit formues të programit të specializimit;
- b) Të paguajnë tarifat e shkollimit dhe të shërbimeve që ofrojnë strukturat universitare dhe spitalore të rrjetit formues të programit të specializimit, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi;
- c) Të tregojnë vëmendjen e duhur ndaj të drejtave të pacientëve, veçanërisht gjatë kryerjes së procedurave mjekësore.

---

<sup>17</sup> Ndryshuar me Vendimin nr.67, datë 21.12.2017 të Senatit Akademik

### **Neni 63**

Studentët e programit të studimeve të specializimit afatgjatë kanë të drejtë të transferohen në vite të ndërmjetme (maksimalisht viti i dytë) në programe specializime afatgjatë. Transferimi i studimeve specializuese afatgjata mund të kryhet vetëm nëse janë parashikuar kuota specifike për këtë qëllim, me propozim të Rektoratit, miratuara në Senatin Akademik, dhe shpallur nga Rektori i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë. Kandidati që aplikon për transferim plotëson formularin bashkëlidhur (Shtojca nr. 2) dhe përcakton programin e specializimit afatgjatë që kërkon.

Në rast se numri i kandidatëve për transferim është me i madh se numri i kuotave, konkurrimi për to është i njëjtë me procedurën e konkurrimit në programin e specializimit afatgjatë.

### **Neni 64**

Në fillim të programit të studimeve të specializimeve afatgjata, specializanti pajiset me Librezën e Studentit sipas formatit të shtojcës nr. 3, ku do të shënohen të gjitha notat dhe vlerësimet vjetore të tij. Libreza e Studentit e shoqëron specializantin deri në përfundimin e programit specializues dhe diplomimin e tij.

Libreza lëshohet nga dekanati në momentin e regjistrimit të studentit dhe përmban dhe foto të studentit. Për të gjitha aktivitetet e parashikuara në programin përkatës specializues, të cilat përmbajnë vlerësim apo kërkohet të certifikohet frekuentimi, studentit paraqitet me librezë, e cila, në përfundim të aktivitetit përkatës plotësohet nga pedagogu që ka qenë përgjegjës për zhvillimin e atij aktiviteti. Plotësimi i librezës është i detyrueshëm. Aplikanti nuk pranohet në aktivitetet përkatëse nëse nuk paraqet librezën.

Në rastet kur studentit humbet librezën, sekretaria përkatëse e pajis atë me një librezë tjetër kundrejt kërkesës së studentit dhe pagesës së parashikuar, si dhe plotëson në librezë aktivitetet e shlyera deri në atë moment nga studentit, të cilat rezultojnë në aktet e sekretarisë.

### **Neni 65**

Specializanti ndjek rregullat e sjelljes etike dhe profesionale me pacientët dhe kolegët dhe fiton aftësi për komunikim korrekt me të tjerët. Konsiderohen shkelje të rregullores së programit të studimeve afatgjata të specializimit, të gjitha veprimet e kryera nga ana e studentit që cenojnë personalitetin dhe integritetin fizik dhe moral të të tjerëve, rregullat dhe normat etiko – morale të shoqërisë, mosrespektimi i kodit të etikës dhe deontologjisë mjekësore, në rastet kur këto veprime nuk kanë elemente të veprave penale. Për veprimet e mësipërme të kryera në mjediset e rrjetit formues gjatë vitit akademik merren këto masa disiplinore:

- a) Këshillim me shkrim;
- b) Vërejtje me shkrim;



- c) Pezullim nga specializimi për vitin akademik;
- d) Çregjistrim nga specializimi.

Masa disiplinore “Këshillim me shkrim” jepet me propozimin e Përgjegjësit të Programit së Specializimit dhe miratimin e Drejtuesit të Departamentit.

Masat disiplinore “Vërejtje me shkrim”; “Pezullim nga shkolla e specializimit për vitin akademik” dhe “Çregjistrim nga shkolla e specializimit” jepen me propozimin e Drejtuesit të Departamentit dhe miratim të Dekanit.

Studenti ka të drejtë të ankohet tek Dekani kundër vendimit të Drejtuesit të Departamentit.

Studenti ka të drejtë të ankohet tek Rektori, kundër vendimit të Dekanit.

#### **Neni 66**

Masa disiplinore merret pasi bëhen të gjithë verifikimet e nevojshme për shkeljen, dëgjohe vetë specializanti i interesuar dhe merret mendimi i Këshillit Drejtues të programit të specializimit afatgjatë dhe përgjegjësit të Departamentit përkatës. Lloji i masës përcaktohet sipas shkallës së shkeljes, faktit nëse ajo është e përsëritur dhe qëndrimit që mbahet ndaj veprimit të kryer. Masat disiplinore merren sipas radhës së mësipërme, përveç rasteve kur nga autoritetet drejtuese të institucionit vlerësohet ndryshe.

#### **V. Menaxhimi i burimeve financiare dhe mekanizmat e përmirësimit të cilësisë dhe performancës të programeve të specializimeve afatgjata**

#### **Neni 67**

Administratori dhe Zyra e Financës pranë fakultetit përkatës, harton një raport financiar, ku pasqyrohet me hollësi kostoja e programit të studimit, që përfshin kostot operacionale, kostot fikse të mjediseve të shkollës dhe pajisjeve, kostot e pagesave të personelit (pedagogë, tutorë, personel ndihmës akademik, ekspertë etj.). Administratori dhe Zyra e Financës bën menaxhimin edhe të të ardhurave dytësore të mbledhura nga tarifat e studimit të programeve të specializimit dhe harton bilancin përfundimtar ekonomik.

#### **Neni 68**

Për përmirësimin e cilësisë dhe ruajtjen e performancës së saj nëpërmjet shqyrtimit dhe mbikëqyrjes së herëpashershme të programeve të studimit të specializimeve afatgjata, në drejtim të pajtueshmërisë të programeve të reja të studimit me strategjinë e fakultetit, universitetit dhe shërbimit shëndetësor, në nivel universitar, funksionon Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, e cila ka si kompetencë vlerësimin periodik të veprimtarive mësimore në njësitë kryesore përbërëse të UMT, në përputhje me standardet. Vlerësimi i programeve të studimit të

specializimeve afatgjata bëhet duke përcaktuar pikat e forta dhe dobësitë për arritjen e objektivit akademik dhe sugjerimet për përmirësimet në të ardhmen. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, në bashkëpunim me të gjithë personelin akademik të përfshirë, bën vetëvlerësimin institucional nëpërmjet instrumenteve dhe metodologjive matëse dhe vlerësuese nëpërmjet informatizimit të të dhënave në një sistem të kodifikuar klasifikimi dhe arkivimi.

### **Dispozita kalimtare dhe të fundit**

#### **Neni 69<sup>18</sup>**

Studenti është i siguar gjatë gjithë periudhës së specializimit dhe për të gjitha aktivitetet e parashikuara në programin specializues. Për këtë disponohet dokumentacion i mjaftueshëm nga institucioni. Një kopje e policës së sigurimit i dorëzohet studentit në momentin e lidhjes së saj.

Studenti sigurohet për përgjegjësinë profesionale për dëmet që mund t'i shkaktojë të tretëve, si dhe për dëmet që mund t'i shkaktohen atij, gjatë periudhës së specializimit dhe ushtrimit të detyrave të parashikuara në programin specializues.

Masa e mbulimit të policës së sigurimit është

1. Sigurim Shëndeti për Specializantët: mbrojtje deri në 1,000,000 lekë,
2. Sigurim i Përgjegjësisë Profesionale ndaj të tretëve: mbrojtje deri në 5,000,000 lekë.

Polica e sigurimit paguhet dhe lidhet nga fakulteti përkatës me kompaninë e sigurimit në favor të studentit.

#### **Neni 70**

Kjo rregullore është hartuar në përputhje me standardet e specializimeve afatgjata në mjekësi dhe me aktet ligjore e nënligjore në fuqi. Rregullorja hyn në fuqi pas miratimit të saj dhe mund të përditësohet çdo vit të ri akademik. Kriteret e përcaktuara për një cikël specializimi në fillim të tij, nuk mund të ndryshojnë gjatë përditësimeve vjetore të rregullores deri në përfundim të atij cikli. Nëse janë të nevojshme, ndryshimet në rregulloret pasardhëse duhet të përjashtojnë shprehimisht ciklin e nisur të specializimit.

#### **Neni 71**

Universiteti i Mjekësisë, Tiranë ka të drejtë të lidhë marrëveshje me institucione publike apo private për kryerjen e programeve të studimeve të specializimeve afatgjata në fushën e mjekësisë, si dhe zgjerimin e rrjetit formues me të cilin UMT bashkëpunon.

---

<sup>18</sup> Ndryshuar me Vendimin nr.4, datë 28.01.2019 të Senatit Akademik

## **Neni 72**

Të zotërojnë të paktën një nga gjuhët e huaja (anglisht, italisht, frëngjisht, gjermanisht, spanjisht) në nivelin B2 si kriter minimal në programet e studimit të ciklit të tretë specializime afatgjata në fushën e mjekësisë, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, me kusht që afati i fundit për paraqitjen e shlyerjes së gjuhës së huaj në nivelin C1, sipas akteve nënligjore në fuqi, për këtë kategori studentësh të jetë përpara përfundimit të vitit të parë akademik.

## **Neni 73**

Të drejtën e përditësimit dhe miratimit të kësaj rregulloreje e ka Senati Akademik i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.

Të drejtën e interpretimit të kësaj rregulloreje e ka Rektori i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.

Kjo Rregullore hyn në fuqi menjëherë pas miratimit në Senatin Akademik të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.

**KRYETARI I SENATIT AKADEMIK**

**PROF. ARBEN GJATA**



## **Shtojca Nr. 1**

Vendet e huaja që plotësojnë përkufizimin "perëndimore" në referencë të përcaktimeve në rregulloren e specializimeve afatgjata në fushën e mjekësisë

- Të gjitha vendet anëtare të Bashkimit Evropian
- Britania e Madhe
- Zvicra
- SHBA
- Kanadaja
- Japonia
- Australia
- Zelanda e Re
- Turqia

## Shtojca 2

### FORMULAR APLIKIMI

Unë i/e nënshkruari/a \_\_\_\_\_, lindur më \_\_\_\_\_  
emri atësia mbiemri

në \_\_\_\_\_, Vendbanimi \_\_\_\_\_

me kartë identiteti/pasaportë nr. \_\_\_\_\_

Adresa \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

Tel \_\_\_\_\_, Cel \_\_\_\_\_, E-mail \_\_\_\_\_

#### KËRKOJ:

Të aplikoj për të vazhduar Specializimin Afatgjatë pranë Fakultetit të \_\_\_\_\_ duke përfitur nga (të shënohet me “x” vetëm një nga alternativat e mëposhtme):

- Kuotat e pranimi të mbuluara nga Ministria e Shëndetësisë/Kuotat e pambuluara (të lira)
- Kuotat e pranimi për Ministrinë e Drejtësisë
- Kuotat e pranimi për Ministrinë e Mbrojtjes
- Kuotat e pranimi për Ministrinë e Punëve të Brendshme

Në momentin e paraqitjes së kësaj kërkesë, nën përgjegjësinë time ligjore,

#### DEKLAROJ se:

- Zotëroj:
  - Diplomë të Integruar të Ciklit të Dytë “Master i Shkencave” në \_\_\_\_\_, lëshuar nga IAL \_\_\_\_\_, Shteti \_\_\_\_\_
  - të njohur në RSH (për diplomat e huaja)
  - Diplomë të Ciklit të Dytë “Master i Shkencave” në \_\_\_\_\_, Lëshuar nga IAL \_\_\_\_\_, Shteti \_\_\_\_\_
  - të njohur në RSH (për diplomat e huaja)
- Kam notë mesatare të ponderuar të gjithë viteve të studimeve universitare (cikli i parë+cikli i dytë ose diplomë e integruar e ciklit të dytë) \_\_\_\_\_ (me dy shifra të rumbullakosura pas presjes dhjetore).

- Nuk jam duke kryer dhe nuk kam kryer më parë një program specializimi afatgjatë në fushën e mjekësisë.
- Zotëroj gjuhën/t e huaj/a më poshtë:
  - Angleze, niveli \_\_\_\_\_
  - Italiane, niveli \_\_\_\_\_
  - Frënge, niveli \_\_\_\_\_
  - Gjermane, niveli \_\_\_\_\_
  - Spanjolle, niveli \_\_\_\_\_
- Bashkëlidhur këtij formulari kam dorëzuar:
  - Letër motivimi.
  - Fotokopje e dokumentit të identifikimit të vlefshëm, kartë identiteti ose pasaportë.
  - Kopje e njësuar me origjinalin në Republikën e Shqipërisë e diplomës universitare, të programit të studimit të ciklit të parë “Bachelor” si dhe të ciklit të dytë “Master i Shkencave”, ose të programit të integruar të studimeve të ciklit të dytë, dhe listës/listave të notave. Për rastet e diplomave të huaja paraqitet kopje e njësuar me origjinalin e vërtetimit të njohjes në Republikën e Shqipërisë, e shoqëruar me diplomën/diplomat dhe listën/listat përkatëse të notave ose të një dokumenti tjetër të vlefshëm për regjistrimin në Universitet në vendin ku janë kryer studimet, të lëshuar nga institucioni i arsimit të lartë përkatës.
  - Për rastet e diplomave të huaja kopje e njësuar me origjinalin e vërtetimit të njohjes në Republikën e Shqipërisë e shoqëruar me diplomën dhe listën përkatëse të notave ose të një dokumenti tjetër të vlefshëm për regjistrimin në Universitet në vendin ku janë kryer studimet të lëshuar nga Institucioni i arsimit të lartë përkatës.
  - Vërtetim që ka dorëzuar dokumentacionin për njohje në organin kompetent (nëse procesi i njohjes nuk ka përfunduar ende). Dokumenti i njohjes duhet të dorëzohet jo më vonë se data e parashikuar për testimin e informatizuar, si dhe përpara shpalljes së rezultatit përfundimtar nga Komisioni i Vlerësimit.
  - Kopje e njësuar me origjinalin në Republikën e Shqipërisë e dokumentit/eve që vërteton/jnë njohjen e gjuhës së huaj/gjuhëve të huaja.
  - Fotokopje e noterizuar e licencës për ushtrimin e profesionit në Republikën e Shqipërisë.
  - Fotokopje e noterizuar e dëshmisë së regjistrimit në Urdhrin Profesional përkatës në Republikën e Shqipërisë.
  - Dëshmi penaliteti e vlefshme.
  - Letër mbështetëse nga Ministria përkatëse.
  - Mandat pagesën për aplikimin dhe konkurrimin (e cila është e pakthyeshme)
  - Dy foto personale.
- Deklaroj se jam në dijeni të faktit se në përfundim të procesit të konkurrimit dhe pas regjistrimit, duhet të paraqes kontratën e nënshkruar me ministrinë përkatëse, jo më vonë se 2 (dy) javë nga data e regjistrimit. Mosrespektimi i kësaj kontrate ka penalitetet përkatës të parashikuara në kontratën e lidhur mes palëve.

- Autorizoj UMT, Ministrinë përgjegjëse për arsimin, Ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë dhe QSHA për trajtimin e të dhënave të mia personale në kuadër të aplikimit dhe regjistrimit për vazhdimin e studimeve specializuese, si dhe publikimin eventual të tyre.
- Autorizoj, gjithashtu, Ministrinë përgjegjëse për arsimin dhe QSHA për kryerjen e të gjitha verifikimeve dhe marrjen e të gjitha informacioneve lidhur me: studimet universitare ku kam aplikuar për t'u regjistruar, periudhën e studimeve të kryera më parë, dhe çdo lloj verifikimi tjetër që lidhet me sa më sipër.
- Deklaroj se nuk kam aplikuar për t'u regjistruar në asnjë institucion tjetër të arsimit të lartë, për vitin akademik në të cilin po aplikoj.
- Deklaroj se nuk po ndjek ndonjë program tjetër studimi në institucione të tjera të arsimit të lartë, dhe se nuk do të ndjek njëkohësisht një program tjetër studimi, deri në përfundimin e programit të studimit ku po aplikoj.
- Deklaroj se jam njohur me rregulloren e specializimeve afatgjata në fushën e mjekësisë, si dhe udhëzimin përkatës të Rektorit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, dhe jam i qartë për procedurat e aplikimit dhe konkurrimit, si dhe plotësoj kriteret e parashikuara në rregulloren e sipërcituar, udhëzimin, si dhe vendimin përkatës të Senatit Akademik të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.
- Deklaroj vërtetësinë e të dhënave dhe dokumenteve të paraqitur. Jam i vetëdijshëm se, në rast deklarimi të të dhënave të pavërteta apo të paraqitjes së dokumenteve të falsifikuara apo me të dhëna jo të vërteta, jam subjekt i masave të parashikuara në Kodin Penal dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi. Në rast dyshimi për vërtetësinë e informacionit të deklaruar, Universiteti i Mjekësisë Tiranë, ministria përgjegjëse për arsimin dhe/ose QSHA nisin procedurën e kontrollit të tyre duke ia përcjellë këto të dhëna eventualisht edhe organeve ligjore kompetente.

( \_\_\_\_\_ )

( \_\_\_\_\_ )

Emër Atësi Mbiemër  
i kandidatit

Emër Mbiemër  
i punonjësit të ngarkuar për pranimin e aplikimit

Firma

Firma

Vendi: \_\_\_\_\_ Data: \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . \_\_\_\_\_, ora \_\_\_\_\_

**Shtojca nr. 2a**

**FORMULAR APLIKIMI (Për transferimet)**

Unë i/e nënshkruari/a \_\_\_\_\_, lindur më \_\_\_\_\_  
emri atësia mbiemri

në \_\_\_\_\_, Vendbanimi \_\_\_\_\_

me kartë identiteti/pasaportë nr. \_\_\_\_\_

Adresa \_\_\_\_\_

Tel \_\_\_\_\_, Cel \_\_\_\_\_, E-mail \_\_\_\_\_

**KËRKOJ:**

Të transferohem për të vazhduar Specializimin Afatgjatë në programin e studimit: \_\_\_\_\_, ID \_\_\_\_\_

Në momentin e paraqitjes së kësaj kërkesë, nën përgjegjësinë time ligjore,

**DEKLAROJ se:**

- Zotëroj:
  - Diplomë të Integruar të Ciklit të Dytë “Master i Shkencave” në \_\_\_\_\_, lëshuar nga IAL \_\_\_\_\_, Shteti \_\_\_\_\_
  - të njohur në RSH (për diplomat e huaja)
  - Diplomë të Ciklit të Dytë “Master i Shkencave” në \_\_\_\_\_, lëshuar nga IAL \_\_\_\_\_, Shteti \_\_\_\_\_
  - të njohur në RSH (për diplomat e huaja)
- Kam notë mesatare të ponderuar të të gjithë viteve të studimeve universitare (cikli i parë+cikli i dytë ose diplomë e integruar e ciklit të dytë) \_\_\_\_\_ (me dy shifra të rrumbullakosura pas presjes dhjetore).
- Po ndjek programin specializues afatgjatë në \_\_\_\_\_ pranë IAL-së \_\_\_\_\_, shteti \_\_\_\_\_
- Zotëroj gjuhën/t e huaj/a më poshtë:
  - Angleze niveli \_\_\_\_\_
  - Italiane niveli \_\_\_\_\_
  - Frënge niveli \_\_\_\_\_
  - Gjermane niveli \_\_\_\_\_
  - Spanjolle niveli \_\_\_\_\_
- Bashkëlidhur këtij formulari kam dorëzuar:
  - Letër motivimi.
  - Fotokopje e dokumentit të identifikimit të vlefshëm, kartë identiteti ose pasaportë.
  - Kopje e njësuar me origjinalin në Republikën e Shqipërisë e diplomës universitare, të programit të studimit të ciklit të parë “Bachelor” si dhe të ciklit të dytë “Master i



Shkencave”, ose të programit të integruar të studimeve të ciklit të dytë, dhe listës/listave të notave. Për rastet e diplomave të huaja paraqitet kopje e njësuar me origjinalin e vërtetimit të njohjes në Republikën e Shqipërisë, e shoqëruar me diplomën/diplomat dhe listën/listat përkatëse të notave ose të një dokumenti tjetër të vlefshëm për regjistrimin në Universitet në vendin ku janë kryer studimet, të lëshuar nga institucioni i arsimit të lartë përkatës.

- Për rastet e diplomave të huaja kopje e njësuar me origjinalin e vërtetimit të njohjes në Republikën e Shqipërisë e shoqëruar me diplomën dhe listën përkatëse të notave ose të një dokumenti tjetër të vlefshëm për regjistrimin në Universitet në vendin ku janë kryer studimet të lëshuar nga Institucioni i arsimit të lartë përkatës.
  - Vërtetim që ka dorëzuar dokumentacionin për njohje në ministrinë përgjegjëse për arsimin (nëse procesi i njohjes nuk ka përfunduar ende). Dokumenti i njohjes duhet të dorëzohet jo më vonë se data e parashikuar për testimin e informatizuar, si dhe përpara shpalljes së rezultatit përfundimtar nga Komisioni i Vlerësimit.
  - Kopje e njësuar me origjinalin në Republikën e Shqipërisë e dokumentit/eve që vërteton/jnë njohjen e gjuhës së huaj/gjuhëve të huaja.
  - Fotokopje e noterizuar e licencës për ushtrimin e profesionit në Republikën e Shqipërisë.
  - Fotokopje e noterizuar e dëshmisë së regjistrimit në Urdhrin Profesional përkatës në Republikën e Shqipërisë.
  - Dëshmi penaliteti e vlefshme.
  - Letër mbështetëse nga Ministria përkatëse.
  - Mandat pagesën për konkurrimin (e cila është e pakthyeshme)
  - Dy foto personale.
  - Planin e plotë të programit të studimit specializues të ndjekur;
  - Vërtetim të listës së notave dhe krediteve të fituara për çdo lëndë dhe detyrim të shlyer, si dhe syllabuset përkatëse për lëndët e shlyera i cili do të shërbejë për ekuivalentimin e notave të lëndëve të programit të studimit të ndjekur;
  - Vërtetim për periudhat e praktikave dhe frekuentimin e aktiviteteve të parashikuara në programin specializues të ndjekur.
- Deklaroj se jam në dijeni të faktit se në përfundim të procesit të konkurrimit dhe pas regjistrimit, duhet të paraqes kontratën e nënshkruar me ministrinë përkatëse, jo më vonë se 2 (dy) javë nga data e regjistrimit. Mosrespektimi i kësaj kontrate ka penalitetet përkatës të parashikuara në kontratën e lidhur mes palëve.
  - Autorizoj UMT, Ministrinë përgjegjëse për arsimin, Ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë dhe QSHA për trajtimin e të dhënave të mia personale në kuadër të aplikimit dhe regjistrimit për vazhdimin e studimeve specializuese, si dhe publikimin eventual të tyre.
  - Autorizoj, gjithashtu, Ministrinë përgjegjëse për arsimin dhe QSHA për kryerjen e të gjitha verifikimeve dhe marrjen e të gjitha informacioneve lidhur me: studimet universitare ku kam

aplikuar për t'u regjistruar, periudhën e studimeve të kryera më parë, dhe çdo lloj verifikimi tjetër që lidhet me sa më sipër.

- Deklaroj se nuk kam aplikuar për t'u regjistruar në asnjë institucion tjetër të arsimit të lartë, për vitin akademik në të cilin po aplikoj.
- Deklaroj se jam në dijeni se para regjistrimit përfundimtar duhet të paraqes dokumentin e çregjistrimit nga programi specializues afatgjatë që jam duke ndjekur, dhe se mosparaqitja e dokumentit të çregjistrimit nuk lejon regjistrimin përfundimtar në programin specializues ku kam aplikuar. Deklaroj se nuk do të ndjek njëkohësisht një program tjetër studimi, deri në përfundimin e programit të studimit ku po aplikoj.
- Deklaroj se jam njohur me rregulloren e specializimeve afatgjata në fushën e mjekësisë, si dhe udhëzimin përkatës të Rektorit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë dhe jam i qartë për procedurat e aplikimit dhe konkurrimit, si dhe plotësoj kriteret e parashikuara në rregulloren e sipërcituar, udhëzimin, si dhe vendimin përkatës të të Senatit Akademik të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë
- Deklaroj vërtetësinë e të dhënave dhe dokumenteve të paraqitur. Jam i vetëdijshëm se, në rast deklarimi të të dhënave të pavërteta apo të paraqitjes së dokumenteve të falsifikuara apo me të dhëna jo të vërteta, jam subjekt i masave të parashikuara në Kodin Penal dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi. Në rast dyshimi për vërtetësinë e informacionit të deklaruar, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë; Ministria përgjegjëse për arsimin dhe/ose QSHA nisin procedurën e kontrollit të tyre duke ia përcjellë këto të dhëna eventualisht edhe organeve ligjore kompetente.

( \_\_\_\_\_ )

( \_\_\_\_\_ )

Emër Atësi Mbiemër  
i kandidatit

Emër Mbiemër  
i punonjësit të ngarkuar për pranimin e aplikimit

Firma

Firma

Vendi: \_\_\_\_\_ Data: \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . \_\_\_\_\_, ora \_\_\_\_\_

### Shtojca Nr. 3: Formati i Librezës së Studentit Specializant

#### Libreza e Specializantit

*Faqja e pare (Frontespici):*

- **Republika e Shqipërisë**
- **Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Rinisë**
- **Universiteti i Mjekësisë, Tiranë**
- Fotografi format dokument

*Faqja e dytë*

- Logo e UMT

#### LIBREZË E SPECIALIZANTIT

Fakulteti .....

Emri, Atësia, Mbiemri .....

Lindur në..... më .....

Nr. i regjistrimit..... Viti .....

DEKANI I FAKULTETIT

Tiranë, më .....

VULA E FAKULTETIT

*Faqe të librezës*

Viti akademik

.....

Grupi .....

Lënda	Pedagogu	Nota	Kredite	Data	Nënshkrimi

*Faqe të librezës*

Viti akademik .....

Grupi .....

PRAKTIKA KLINIKE DHE PROFESIONALE				
Emërtimi	Udhëheqësi klinik	Vlerësimi	Data	Nënshkrimi

*Faqe të librezës*

#### Provimi Vlerësues Vjetor Teorik dhe Praktik

Viti Akademik .....

Testimi Praktik                      Nota.....

.....                                      ...                      Data .....

Testimi me gojë                      Nota.....  
.....                                      ...                      Data .....

Nota e përbashkët                      Kaluese.....  
.....                                      ...                      Jokaluese.....

Përgjegjësi i Programit të Specializimit .....

Komisioni Vlerësues .....

*Faqe të librezës*

### **Provimi Vlerësues Përfundimtar**

Viti Akademik .....

Testimi Praktik ..... Nota ..... Data .....

Testimi me gojë ..... Nota ..... Data .....

Tema eksperimentale – studimore e diplomës .....Nota ..... Data .....

Nota e përbashkët .....

Përgjegjësi i Programit të Specializimit .....

Komisioni Vlerësues .....

### *Faqja e fundit*

Shënime:

1. Libreza e specialistit shërben për të gjithë periudhën e studimeve.
2. Libreza duhet ruajtur me kujdes dhe e pastër.